



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

NR. ____ . DATË ____ 2021

“PËR

TREGUESIT STATISTIKORË TË VLERËSIMIT E MONITORIMIT
TË PROGRAMEVE TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË PAGESËS
PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE SHËRBIMEVE
SHOQËRORE, SI EDHE PERIODICITETIN E MBLLEDHJES SË
TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 19, pika 3, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 31, shkronja c e ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Monitorimi dhe vlerësimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore realizohen në nivel vendor e kombëtar dhe kanë për qëllim:
 - a) monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të objektivave, të masave e veprimeve, në zbatim të legjislacionit, strategjive dhe programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror, rezidenciale apo komunitare, të ofruara nga persona juridikë, publikë dhe privatë;
 - b) vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve, në zbatim të politikave dhe programeve të mbrojtjes shoqërore;
 - c) vlerësimin e ndikimit të politikave në uljen e varfërisë, shmangien e përjashtimit shoqëror dhe garantimin e mundësive të barabarta;

ç) hartimin e rekomandimeve dhe të politikave për mbështetjen e grupeve në nevojë.

2. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe struktura në varësi të saj, grumbullojnë dhe përpunojnë të dhëna statistikore, si dhe hartojnë raporte, për:

a) përcaktimin e nevojave për shërbime të përkujdesit shoqëror për grupet në nevojë të popullsisë;

b) përcaktimin e nevojave për mbështetje me pagesa dhe/ose shërbime të familjeve dhe individëve në nevojë;

c) përcaktimin e numrit dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, që ofrohen nga personat juridikë, publikë dhe privatë, organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në nivel qarku dhe bashkie;

ç) vlerësimin e nevojave për shërbime të reja të përkujdesit shoqëror, në përputhje me kërkesat dhe burimet për ngritjen e tyre.

3. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror çdo 2 muaj, brenda datës 15 të muajit pasardhës, dërgojnë të dhëna statistikore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror për numrin e familjeve/individëve, që aplikojnë për ndihmë ekonomike, për numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe për fondet e përdorura, sipas modularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Bashkitë çdo 2 muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, dërgojnë në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të dhëna statistikore për numrin e personave me aftësi të kufizuara, që mbështeten me pagesë, si dhe për fondet e përdorura, sipas modularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për bashkitë në të cilat zbatohet vlerësimi bio-psiko-social të dhënat statistikore dërgohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror nga drejtoritë rajonale nën juridiksionin e së cilës janë këto bashki.

5. Bashkitë çdo 2 muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, dërgojnë në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të dhëna statistikore për numrin dhe llojet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, që ofrohen nga personat juridikë, publikë dhe privatë, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe për nevojat për shërbime të reja të përkujdesjes shoqërore, sipas modularit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Personat juridikë, publikë dhe privatë, dhe organizatat jofitimprurëse të licencuara sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, dërgojnë çdo 2 muaj,

brenda datës 10 të muajit pasardhës, në bashkinë/njësinë administrative, ku ofrojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror, si dhe në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të dhëna statistikore për shërbimet e përkujdesit shoqëror të ofruara dhe numrin e përfituesve, sipas modularit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, vlerëson, përpunon dhe standardizon të dhënat e grumbulluara sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6 të këtij vendimi, dhe i dërgon brenda datës 15 të muajit pasardhës, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

8. Bashkitë, personat juridikë, publikë dhe privatë, e organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, i dërgojnë një kopje të raportit të të dhënave, sektorit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qark.

9. Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, lidh akt marrëveshje me institucione të tjera për shkëmbimin e të dhënave statistikore, periodike.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara në përputhje me standardet e përcaktuara me udhëzim të ministrit, i dërgon në Ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale dhe në Institutin e Statistikave.

11. Ngarkohet Ministri përgjegjës për çështjet sociale të nxjerrë udhëzim për mënyrën e paraqitjes së të dhënave statistikore për programin e ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

12. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe njësitë e vetqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

13. Vendimi nr. 617, datë 07.09.2006 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Modular 2 Programi i Afësisë së Kufizuar

1.	Personat me aftësi të kufizuara (PAK)	Numri i PAK	Tregon numrin e PAK në bashki që përfillojnë pagesë të afësisë së kufizuar	Sipas llojit të afësisë së kufizuar Sipas masës së përfillimit të pagesës Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 2 muaj
2.	Numri i ndihmësve personal	Numri i ndihmësve personal e bashki që përfillojnë pagesë	Tregon numrin e ndihmësve personal në bashki që përfillojnë pagesë	Sipas llojit të afësisë së kufizuar së cilës i shërbejnë Sipas llojit të shërbimit Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 2 muaj
3.	Numri i invalidëve të punës	Numri i invalidëve të punës	Tregon numrin e invalidëve të punës në bashki që përfillojnë pagesë shtesë për aftësi të kufizuar	Sipas sëmundshmërisë dhe grupit të invaliditetit (sëmundje të përgjithshme, grupi I/II dhe sëmundje profesionale, grupi I/II) Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 2 muaj
4.	Fondi mujor i PAK dhe ndihmësve personale	Fondi mujor i PAK dhe ndihmësve personale	Tregon fondin mujor në lekë të shpenzuar për çdo bashki (në 000/lekë).	Sipas llojit të afësisë së kufizuar	Çdo 2 muaj
5.	Fondi mujor për invalidët e punës	Fondi mujor për invalidët e punës	Tregon totalin e fondit të shpenzuar për pagesën e invalidëve të punës në bashki (në 000/lekë)	Sipas sëmundshmërisë dhe grupit të invaliditetit (sëmundje të përgjithshme, grupi I/II dhe sëmundje profesionale, grupi I/II)	Çdo 2 muaj
6.	Numri i individëve PAK që përfillojnë kompensime	Numri i individëve PAK që përfillojnë kompensime	Tregon numrin e PAK në bashki që që përfillojnë kompensime	Sipas llojit të afësisë së kufizuar Sipas llojit të kompensimit Sipas gjinisë	Çdo 2 muaj
7.	Numri i feminjëve me aftësi të kufizuar	Numri i feminjëve me aftësi të kufizuar	Tregon numrin e feminjëve me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç) në bashki	Sipas afësisë së kufizuar Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas sistemit arsimor që ndjekin	Çdo 2 muaj

Modular 1 – Programi Ndihmës Ekonomike (NE)

Nr.	Grupi i synuar	Indikator i monitorueshëm	Përbajtja	Specifikime	Periodiciteti
1.	Familjet/individët në nevojë	Numri i familjeve aplikuese dhe përfutnese të skemës së NE.	Tregon numrin e familjeve / individëve në bashki që aplikojnë /përfitojnë NE për periudhën	Përfutes nga sistemi i pikezimit Përfutes nga fondi 6% mbi bazën e kritereve specifike Sipas numrit të anëtarëve Sipas kategorisë familje/individ Sipas kohëzgjatjes në skemë Sipas gjinisë së kryefamiljarit Sipas grupmoshave (parashkollorë, shkolle 9-vjeçare, arsim i mesëm) Sipas gjinisë Sipas arsimit që ndjekin Sipas grupmoshave Sipas gjinisë	Çdo 2 muaj
2.		Numri i familjeve me fëmijë 0-5, 6-15 vjeç dhe 16-18 vjeç	Tregon numrin e familjeve në bashki që përfitojnë NE të cilët kanë në përbërje fëmijë të grupmoshës 0-5, 6-15 vjeç, 16-18 vjeç.		Çdo 2 muaj
3.		Numri i familjeve të NE që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara (PAK)	Tregon numrin e familjeve në bashki që përfitojnë NE për periudhën dhe që kanë në përbërje PAK		Çdo 2 muaj
4.		Numri i familjeve që hyjnë në skemën e NE	Tregon numrin e familjeve në bashki që futen në skemën e NE		Çdo 2 muaj
5.		Numri i familjeve që dalin nga skema e NE	Tregon numrin e familjeve në bashki që dalin nga skema e NE	Sipas numrit të anëtarëve	Çdo 2 muaj
6.		Numri i familjeve që urajohen nga fondet e pushtetit lokal dhe përfutime në natyrë	Tregon numrin e familjeve në bashki, që mbi bazën e kritereve specifike mbështeten me fondet e pushtetit vendor me ndihmë ekonomike ose forma të tjera ndihme	Sipas shkallës së daljes nga skema Sipas numrit të anëtarëve Sipas grupmoshës së fëmijëve apo PAK në përbërje të familjes Sipas gjinisë së kryefamiljarit	Çdo 2 muaj
7.		Fondi mujor i NE	Tregon fondin mujor në lekë të shpenzuar për çdo bashki (në 000/lekë).	Fondi i përfutjesve nga sistemi i pikezimit Fondi i përfutjesve nga 6% Sipas llojit të kompensimit	Çdo 2 muaj
8.		Numri i familjeve të NE që përfitojnë kompensime	Tregon numrin e familjeve që përfitojnë kompensime		Çdo 2 muaj

Modular 3 Shërbimet e përkujdesit shoqëror

Nr.	Grupi i synuar	Indikator i monitorueshëm	Përbajtja	Specifikime	Periodiciteti
1.	Fëmijë në nevojë	Numri i gendrave/shërbimeve publike të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e gendrave/shërbimeve rezidenciale ose diore që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në nivel qarku dhe bashkie	Sipas llojit të gendrës / shërbimit Sipas statusit të përfutjesit Në nivel Bashkie Në nivel Qarku Shërbim i rrikzistues	Çdo 2 muaj
2.		Numri i përfutjesve të vendosur gendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e përfutjesve të gendrave/shërbimeve sociale në qarku dhe bashkie	Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas gjendjes së aftësisë / aftësisë së kufizuar	Çdo 2 muaj
3.		Numri i kërkesave për përfutim të shërbimeve shoqërore në gendrat /shërbimet publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfutur shërbime të përkujdesit shoqëror në gendrat/shërbimet publike	Sipas statusit (social, arsimor, familjar) të përfutjesve Sipas llojit të shërbimit që kërkohet	Çdo 2 muaj
4.		Fondi i shpenzimeve në gendrat/shërbimet publike të përkujdesit shoqëror	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në gendrat/shërbimet publike të përkujdesit shoqëror në qark/bashki për periudhën (000/lekë)	Sipas grupmoshës së kërkuesit Sipas gjinisë së kërkuesit	Çdo 2 muaj
5.		Numri i gendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e gendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimeve që ofrojnë për përfutjes të ndryshëm Në nivel Bashkie Në nivel Qarku Shërbim i rrikzistues	Çdo 2 muaj
6.		Numri i përfutjesve të gendrave/shërbimeve jopublike	Tregon numrin e përfutjesve që ofrojnë shërbime shoqërore në qark/bashki në gendrat/shërbimet jopublike	Sipas statusit (social, arsimor, familjar) të përfutjesve Sipas grupmoshëve Sipas gjinisë Sipas gjendjes së aftësisë / aftësisë së kufizuar	Çdo 2 muaj

7.		Numri i përfutjes në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga struktura përkatëse (shërbëtorë apo OJF) të përfutjes që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki	Sipas gjendjes familjare, shoqërore, shëndetësore, arsimimit, Sipas grupmoshës	Çdo 2 muaj
8.	Gra në nevojë	Numri i gendrave/shërbimeve publike të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin i gendrave/shërbimeve rezidenciale ose diore që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie	Sipas llojit të gendrës/shërbimit Sipas statusit të përfutjesve Në nivel Bashkie Në nivel Qarku Shërbim i rir/ezisues	Çdo 2 muaj
9.		Fondi i shpenzimeve në gendrat/shërbimet publike të përkujdesit shoqëror	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në gendrat/shërbimet publike të përkujdesit shoqëror në qark/bashki për periudhën (000/lehtë)	Sipas llojit të gendrës/shërbimit Sipas statusit të përfutjesve	Çdo 2 muaj
10.		Numri i gendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbim të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin i gendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 2 muaj
11.		Numri i përfutjesve të shërbimeve të përkujdesit	Tregon numrin e përfutjesve që përfillojnë shërbime të përkujdesit shoqëror (publike apo jopublike) në qark/bashki	Sipas llojit të gendrës Sipas llojit të shërbimit Sipas grupmoshës Sipas statusit familjar, shoqëror, shëndetësor etj Sipas gjendjes sociale Sipas vendbanimit Sipas nivelit arsimor Sipas statusit të punësimit	Çdo 2 muaj
12.		Numri i përfutjesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga struktura përkatëse (shërbëtorë apo OJF) të përfutjesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki	Sipas gjendjes familjare shoqërore, shëndetësore, arsimimit Sipas grupmoshës Sipas gjendjes sociale Sipas vendbanimit Sipas nivelit arsimor Sipas statusit të punësimit	Çdo 2 muaj
13.	Të rinj në nevojë	Numri i	Tregon numrin e	Sipas llojit të gendrës/shërbimit	Çdo 2 muaj

		qendrave/shërbimeve publike të përkujdesit shoqëror	qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose diore që ofrojnë shërbime e përkujdesit shoqëror për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie	Sipas statutit të përfutësve Në nivel Bashkie Në nivel Qarku Shërbim i ri/ekzistues	
14.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesit shoqëror	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesit shoqëror në qark/bashki në (000/lekë)	Sipas llojit të qendrës/shërbimit Sipas statutit të përfutësve	Çdo 2 muaj
15.		Numri i qendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e OJF-ve që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 2 muaj
16.		Numri i përfutësve të përfutësve të shërbimeve të përkujdesit	Tregon numrin e përfutësve që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror (publike apo OJF) në qark/bashki	Sipas llojit të qendrës/shërbimit Sipas grupmoshës Sipas statusit familjar, shoqëror, shëndetësor etj. Sipas gjinisë Sipas nivelit arsimor	Çdo 2 muaj
17.		Numri i përfutësve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shërbime apo OJF) të përfutësve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki	Sipas gjendjes familjare, shoqërore, shëndetësore, arsimimit Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj
18.	Të moshuar në nevojë	Numri i qendrave/shërbimeve publike të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose diore që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie	Sipas numër të përfutësve Në nivel Bashkie Në nivel Qarku Shërbim i ri/ekzistues	Çdo 2 muaj
19.		Numri i përfutësve të vendosur qendra/shërbimet publike	Tregon numrin e përfutësve të shërbimeve sociale në qendrat/shërbimet publike në nivel qarku dhe bashkie	Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas statusit të përfutësve Sipas gjendjes familjare /shëndetësore/afësisë Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj

20.		Numri i kërkesave për përfilim të shërbimeve shogërore në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfiluar shërbime të përkujdesit shogëror në qendrat/shërbimet publike	Sipas statusit të kërkuarit Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas gjendjes familjare /shëndësore /aftësisë Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj
21.		Fondi i shpenzimeve në qendrat/shërbimet publike të përkujdesit shogëror	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat/shërbimet publike të përkujdesit shogëror në qark/bashki për periudhën (000/leke)	Sipas numrit të përfituesve Sipas llojit të shërbimit Sipas burimit të financimit	Çdo 2 muaj
22.		Numri i gendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shogëror	Tregon numrin e gendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 2 muaj
23.		Numri i përfituesve të shërbimeve nga qendrat/shërbimet jopublike	Tregon numrin e përfituesve që përfillojnë shërbime shogërore në qark/bashki nga qendrat/shërbimet jopublike	Sipas gjendjes së përfitësit Sipas grupmoshëve Sipas gjinisë Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj
24.		Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shogërore në bashki	Sipas gjendjes familjare, shëndësore, Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj
25.	Persona me aftësi të kufizuara	Numri i gendrave/shërbimeve publike të përkujdesit shogëror	Tregon numrin e gendrave/shërbimeve publike rezidenciale ose diore që ofrojnë shërbime të përkujdesit shogëror për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie	Sipas llojit të shërbimit Në nivel Bashkie Në nivel Qarku Shërbim i ri/ekzistues	Çdo 2 muaj
26.		Numri i përfituesve të vendosur në qendrat/shërbimet publike	Tregon numrin e përfituesve të shërbimeve sociale në qendrat/shërbimet publike në nivel qarku dhe bashkie	Sipas llojit të aftësisë së kufizuar Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas gjendjes familjare Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj
27.		Numri i kërkesave për përfilim të shërbimeve shogërore	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie për të përfiluar	Sipas statusit të kërkuarit Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 2 muaj

	gendrat/shërbimet publike	shërbime të përkujdesit shoqëror në gendrat/shërbimet publike			
28.	Fondi i shpenzimeve në gendrat/shërbimet publike të përkujdesit shoqëror	Tregon totalin e fondi të shpenzuar në gendrat/shërbimet publike të përkujdesit shoqëror një qark/bashki (në 000/lekë)	Sipas llojit të shërbimit Sipas numrit të përfituesve Sipas llojit të financimit	Çdo 2 muaj	
29.	Numri i gendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbim të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e gendrave/shërbimeve jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj	
30.	Numri i përfituesve të shërbimeve nga gendrat/shërbimet jopublike	Tregon numrin e përfituesve që përfillojnë shërbime shoqërore në qark/bashki nga gendrat/shërbimet jopublike	Sipas llojit të aftësisë së kufizuar Sipas grupmoshave Sipas gjinisë Sipas gjendjes familjare Sipas vendbanimit	Çdo 2 muaj	
31.	Numri i përfituesve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shëtitërore apo OJF) të përfituesve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki	Sipas gjendjes familjare, shëndetësore Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas llojit të aftësisë së kufizuar	Çdo 2 muaj	